

## **NJOFTIM PËR SHPALLJE KONKURRIMI PËR VEND TË LIRË PUNE**

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, *i ndryshuar*, ligjit nr. 114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, *i ndryshuar*, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST) shpall procedurën e rekrutimit për pozicionin e mëposhtëm:

### **Auditues, Audit i Brendshëm**

#### **PËRSHKRIMI PËRGJITHËSUES I PUNËS PËR POZICIONIN:**

- Kryerja e angazhimeve të auditimit të brendshëm, sipas udhëzimeve dhe metodave të miratuara nga Ministria e Financave, për të vlerësuar nëse sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, si dhe performanca e njësisë së audituar janë transparente dhe në përputhje me normat e ligjshmërisë, të rregullshmërisë, të ekonomisë, efektivitetit dhe efijencës;
- Sigurimi i cilësisë dhe dokumentimin e veprimtarive audituese apo mbështetja e çdo konstatimi me letrat e punës, sipas përcaktimeve të manualit të Auditimit të Brendshëm;
- Zbatimi me rigorozitet i drejtimeve të programit të angazhimit, hartimi i projektraportit dhe raportit final dhe draft konkluzioneve për subjektin e audituar;
- Ndjekja dhe raportimi periodikisht për gjetjet, përfundimet dhe dërgimi i rekomandimeve/përfundimeve të auditimit tek subjektet ku janë kryer angazhimet, si dhe përgatitja e informacionit për rekomandimet e pazbatuara nga drejtuesit e subjektit të audituar e për pasojat e moszbatimit të tyre;
- T’i propozojë drejtuesit të njësisë së auditimit dhe, nëpërmjet tij, drejtuesit të subjektit, pezullimin, deri në shqyrtimin nga organi përkatës, në rastet kur konstatojnë veprime të kundraligjshme, të cilat dëmtojnë rëndë interesat e subjektit dhe/ose janë të arsyetuara e përbëjnë vepër penale;
- T’i japë rekomandime subjektit të audituar për ndreqjen e parregullsive, për masat që duhen ndërmarrë në rastet e konstatimit të dëmeve, ekonomike dhe financiare, për zhdëmtimin e tyre, si dhe të bëjë propozime, të cilat synojnë të ulin mundësinë e përsëritjes së këtyre rasteve në të ardhmen;
- Të plotësojë dosjen e auditimit me të gjithë komponentët përbërës/ pyetësor/çeklistat, dokumentat justifikues, formularët statistikorë të matjes së

- suksesit dhe performancës si dhe të inventarizojë atë me qëllim dorëzimin në arkivën e institucionit;
- Përditëson rregullisht njohuritë dhe aftësitë profesionale, për të garantuar cilësinë e shërbimit.

## 1.1

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE KRITERET E VEÇANTA QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI**

#### **Kushtet që duhet të plotësojë kandidati janë:**

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f. Të gëzojë integritet moral dhe profesional, të mos ketë marrë masa disiplinore për cënim të rregullave të etikës, si dhe mos të ketë masë disiplinore në fuqi;
- g. Të mos ketë lidhje familjare me punonjës të tjerë të administratës me të cilët kanë lidhje hierarkie.

#### **KANDIDATI DUHET TË PLOTËSOJË KRITERET E VEÇANTA SI VIJON:**

- a) Të kenë diplomë të arsimit të lartë të ciklit të dytë të studimeve në shkencat ekonomike, juridike,inxhinierike;
- b) Të ketë përvojë pune jo më pak se 3 vjet në profesion dhe të jetë i certifikuar si “Auditues i Brendshëm në sektorin publik”, përparësi i jepen kandidatëve që kanë ushtruar funksionin e audituesve;
- c) Të zotërojë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- d) Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

## 1.2

### **DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Kërkesë për të konkurruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse;
- b- Jetëshkrimin (Curriculum Vitae);
- c- Fotokopje të dokumentit të arsimit (*Nëse studimet janë kryer jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit*);
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (vlefshmëria 3 muaj);
- g- Dëshmi Penaliteti;
- h- Vërtetim nga Gjykata;

- i- Vërtetim nga Prokuroria;
- j- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Në përfundim të procedurës së rekrutimit, dokumentacioni i dorëzuar nuk do t'u kthehet kandidatëve, pasi bëhet pjesë e arkivës për procedurën e rekrutimit në institucion.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër do të bëhet duke u dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., me adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 9 Yrshek, Kashar, Tiranë, gjithashtu mund të dorëzohen edhe nëpërmjet postës elektronike: [info@ost.al](mailto:info@ost.al) , brenda datës **24.04.2026**.

*\*Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta për pozicionin e shpallur do të njoftohen mbi datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista me gojë.*

### 1.3

## **FAZAT E KONKURRIMIT NË OPERATORIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SH.A. (OST)**

**Konkurrimi në Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST) bëhet në tre faza:**

1. Në fazën e parë, bëhet përzgjedhja e kandidatëve që do t'i nënshtrohen testimit me shkrim dhe me gojë e cila konsiston në verifikimin nëse dokumentacioni i paraqitur nga çdo kandidat vërteton plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të kërkesave specifike, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.  
Vetëm kandidatët që plotësojnë këto kërkesa, i nënshtrohen fazave të mëtejshme të konkurimit.
2. Në fazën e dytë zhvillohet testimi me shkrim:
  - për nivelin e njohurive të përgjithshme;
  - për nivelin e njohurive profesionale.
3. Në fazën e tretë zhvillohet intervistimi i kandidatëve, e cila synon të evidentojë formimin e përgjithshëm.